



Zyra për Informim

Duke u bazuar të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 92 paragrafi 1, nenit 17, 18 19, 20, 21 dhe 22 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë Nr.03/2019, Planit të Komunal të Veprimit për Transparencë 2019-2023 si dhe vendimeve të miratuar nga Kuvendi Komunal Nr.32/2019 dhe 33/2019 të datës 26.12.2019, për shpalljen konsultimit publik për Draft Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE-2019-2021 dhe Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024, Zyra për Informim, drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Rahovecit shpallë këtë;

NJOFTIM PUBLIK

LIDHUR ME DRAFT PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË PKVEE-2019-2021 DHE PLANIN LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS 2019-2024

Draft Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE-2019-2021 dhe Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024 do të jetë për shqyrtim publik prej datës: **20.01.2020** deri **20.02.2020**.

Komuna e Rahovecit, ka publikuar Draft Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE-2019-2021 dhe Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024, në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/rahovec-4/debat-publik/>.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet për plotësim ndryshim mund të paraqiten në Zyrën e drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e cila gjendet në katin e I në objektin e ri të Administratës Komunale në Rahovec. Gjithashtu komentet mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike në emailat: bjondina.ramaj@rks-gov.net, Shpejtim.Mustafa@rks-gov.net, skender.hamza@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Ndërkaq diskutimi publik do të mbahet me datën: **20.02.2020 (e Enjte) në ora 11:00** në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit.

Diskutimi publik është i hapur për të gjithë qytetarët e interesuar që të jenë pjesë e këtij diskutimi.

Ju mirëpresim!